



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 250/1 Prot.

Shkodër, më 10.04.2025

P. 1486/1 Prot
Dt. 11.04.25



Lënda: Mbi Vendimin Nr. 24, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27, pika 6, neni 54, shkronja “n”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 30, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 9693 “Për fondin kullosor”, neni 26, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, shqyrtoi vendimin Nr. 24, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës “Për miratim e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025 në territorin administrative të Bashkinë Vau Dejës”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Në vemendjen tuaj, kullotat e livadhet inventarizohen çdo 10 vjet, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së linjës.

Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki organizon çdo vit fushata informimi, sensibilizimi dhe trajnimi për parandalimin e zjarreve në pyje, proces për të cilin duhet të lini gjurmë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 24 datë 26.03. 2025

**“Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin
Pyjor e Kullosor per vitin 2025”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 26.03. 2025, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, Bazuar në Ligjin Nr.57/2020, datë 30.4.2020: “Për Pyjet”, neni 30, pika c; Ligjin nr Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për fondin kullosor” i ndryshuar. Ligji Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; Ligji Nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”; ligjit nr 45, date 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”; VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota:

V E N D O S I

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025.
2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

**KRYETAR KËSHILLI
ERVIS SHIMAJ**

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.04. 2025



**SEKRETAR KËSHILLI
ARDIAN ÇELEPIJA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, BUJQËSISË DHE MBROJTJES SË

MJEDISIT

SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

Nr. 942/prot.

Vau Dejës, më 24.02.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar z. Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues “Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025”.

Me respekt,

KRYETARI I BASHKISË

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 9

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 64



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, BUJQËSISË DHE MBROJTJES SË
MJEDISIT

SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE

PROJEKT V E N D I M

Nr. 03, datë 24.02.2025

**“Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin
Pyjor e Kullosor për vitin 2025”**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, nenit 27 pika 5, neni 64 germa “c” të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenin 30 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit Nr.57 datë 30.4.2020: “Për Pyjet”, i ndryshuar; nenin 26 germa “c” të ligjit Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar; ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pikën 49, shtojca 47 të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar; nenin 11, nenin 30 germa “i”, “j”, “k” të ligjit nr. 45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”; VKM –në nr. 807 datë 28.12.2023 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”; Urdhërin nr.1024, datë 06.11.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës “Mbi ngritjen e Komisionit Vendor të Mbrojtjes Civile, në Bashkinë Vau Dejës; kreun III i ligjit Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; VKM-në nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota” ligjin Nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës _____._____2025 të:

VENDOSI

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025.

HARTOI PROJEKT-VENDIMIN DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, BUJQËSISË DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Konceptoi: Mark Suli, Specialist



Pranoi: Zeqir Ujka, Përgjegjës



Miratoi: Vehbi Shkjau, Drejtor



**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
ALEKSANDRA GJONI**




Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve:

Konfirmoi bazën ligjore të projekt-vendimit: Ersilda Preka, Specialist



Pranoi bazën ligjore të projekt-vendimit: Marinela Deda, Drejtor





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, BUJQËSISË DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE

Nr. 7 Prot.

Vau Dejës, me 29/02 2025

RELACION

“Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau-Dejës ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në pjesën veriore të vendit. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, kryeqyteti i vendit është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Shkodrës, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me Bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e Bashkisë është qyteti i Vau Dejës.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Vau-Dejës, Temal dhe Shllak. Bashkia ka nën administrim 47 fshatra dhe një qytet. Njësia administrative Bushat ka numrin më të lartë të fshatrave (14 fshatra), i cili vijohet nga Temal (10 fshatra). Njësitë administrative Vig Mnelë dhe Hajmel kanë një numër shumë të vogël të fshatrave, respektivisht tre dhe pesë. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Shkodër të Qarkut Shkodër.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau Dejes, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5 i këtij Ligji ku parashikohet:

“Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit

... 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.”

Në Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 11 parashikohet:

“Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë

Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, miraton, minimalisht çdo pesë vjet, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.”

Në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet” i ndryshuar, neni 30 parashikohet:

“Mbrotjtja e fondit pyjor kombëtar

4. Për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor kombëtar:

b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe pronarët privatë, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile;

c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, detyrohen sipas ligjit përkatës për mbrojtjen civile të garantojnë mbrojtjen nga zjarret në këto sipërfaqe, duke hartuar/përditësuar planet për mbrojtjen e tyre nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë dhe prefekturës, si edhe detyrimin për rregulloret e brendshme të tyre”.

Ligji Nr. 9693 datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, neni 26 parashikon:

“Organet e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe, kanë këto kompetenca:

c) marrin masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre”

Ligji nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, paraqet:

“Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

“Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim” është tërësia e masave tekniko organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.

VKM-ja nr.1080 datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota” parashikon:

“1. Për parandalimin dhe zbulimin në kohë të rreziqeve nga zjarret në pyje e kullota, si dhe për shuarjen e tyre, drejtoritë përkatëse të shërbimit pyjor kryejnë këto detyra:

a) Hartojnë planet e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyjet dhe kullotat, në pronësi e në administrim të qeverisjes qendrore, në përputhje me planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyjet dhe kullotat, të miratuar nga ministri përgjegjës, dhe me udhëzimet e Drejtorisë së Emergjencave Civile. Në këto plane të jepen në mënyrë të hollësishme masat e veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarri. Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.”

Bazuar në ligjin Nr. 57 datë 30.4.2020 “Për Pyjet” i ndryshuar, ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar, ligjin Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si edhe VKM-në nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, hartohet plani operativ për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota është e nevojshme të kryhen punime paraprake në hapjen e koridoreve në pyjet që kanë reziqshmëri me të lartë në rënien e zjarreve, si dhe vendosja e sinjalistikës për zjarret, si sensibilizim i komunitetit.

Në rastin e shfaqjes së zjarreve në Pyje e Kullota, organizohen forca dhe mjete, të cilat krahas punës në shuarjen e zjarreve kanë edhe kostot e tyre.

Për këtë nevojitet një fond i vecantë, brenda fondit prej 4% të planifikuar për emergjencat civile sipas ligjit. Më poshtë jepet preventivi përkatës:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vlera Njësi	Vlera Lekë
1	Sinalistike për mbrojtjen nga zjarri, vendosje tabeta, parudha, etj	Cope	10	5000	50000

2	Hapje koridore ne pyje per parandalimin e zjarreve	Ha	3	100000	300000
3	Honorare per fikje zjarri nga vullnetaret	orë pune	2500	229.9	574750
4	Ore shtese jashte orari zyrtar e personelit pyjor dhe strukturave tjera te bashkisë.	orë pune	1000	287	287000
5	Karburant	litra	1800	180	324000
	Totali				1.535.750

Duke ju falenderuar, ju ftojmë në miratimin e projekt vendimit.

Specialist

Ing .Mark Suli



Pergjegjes Sektori

Ing.Zeqir Ujka



Drejtore

Vehbi Shkja



KRYETARI I BASHKISË

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni

